

Luftës në Malishevë/Mališevo.

**Burimet:** deklarata V.M, FDH-15650; HRW, *Shkeljet...*, 73, FDH-31132; KMDLNJ, *Buletini*, num. 9, tetor-dhjetor 1998, 122, FDH-23857; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; J. Osmani, *Krimet...*, I, 543.

### **Hyre (Rrustem) Rama**

(13.06.1919, shqiptare nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, katër fëmijë)

### **Zade (Hasan) Karaqica**

(5.10.1936, shqiptare nga Balinca/Balinçe, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, katër fëmijë)

### **Elvane (Ibrahim) Shala**

(3.06.1960, shqiptare nga Banja, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise, shtatë fëmijë)

### **Sevdije (Ramë) Krasniqi**

(1974, rome nga Caralluka/Crni Lug, komuna e Malishevës/Mališevo, amvise)

### **Halime (Jakup) Halitaj**

(3.11.1981, shqiptare nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo, nxënëse)

### **Valentina (Ilaz) Shala**

(25.08.1988, shqiptare nga Banja, komuna e Malishevës/Mališevo)

### **Altin (Malush) Rama**

(25.02.1993, shqiptar nga Seniku/Senik, komuna e Malishevës/Mališevo)

### **Xhafer (Fadil) Shala**

(9.12.1997, shqiptar nga Banja, komuna e Malishevës/Mališevo)

Gjatë verës së vitit 1998, në Senik u strehuan mbi dy mijë refugjatë nga fshatrat përreth. Në shtëpinë e Jakup Halitajt u strehuan motra e tij Zade me familjarët e vetë nga Balinca/Balinçe, e bija Sofije me djemtë Xhaferin dhe Arsenin, vjehrrën dhe vjehrrin, si dhe dy kunata nga Banja. Te Jakupi u strehua edhe Elvanja, bashkëshortja e Ilaz Shales [i afërm i bashkëshortit të Sofijes].

Në fund të korrikut, nga droja prej forcave serbe që qarkullonin nëpër fshat, banorët dhe të zhvendosurit e braktisën Senikun/Senik për tri ditë. Pastaj u kthyen dhe deri më 26.08.1998 nuk lëviznin nga fshati.

Në datën 26.08.1998, pjesëtarët e UJ-së erdhën nga drejtimi i Malishevës/Mališevo dhe u stacionuan në vreshtat e ndërmarrjes *Mirusha/Mirusha*, në afërsi të rrugës kryesore në mes të Senikut/Senik dhe fshatit fqinj të Bellanicës/Belanica. Nga paniku, banorët dhe refugjatët e braktisën fshatin dhe u vendosën në pyllin përmbi fshatin e Senikut/Senik, i cili kufizohet me fshatin Kleçkë/Klečka [Lipjan/Lipljan]. U përqendruan kryesisht në tre vende: *Male te Mrizet, Ara e Bajramit/Bajramova njiva* dhe *Lugu i Ahut/Bukova dolina*.

Të nesërmen, më **27.08.1998**, rreth orës 12:00, forcat serbe kanë hyrë në Kleçkë/Klečka. Nga ora 16:00, ato hapën zjarr nga Klečka/Klečka mbi turmën e strehuar në pyll [**Senik**], së pari nga armë automatike, e pastaj nga tanket. Predhat binin në mes të njerëzve. Ciflat e predhave ua morën jetën Zades së moshëthyer, Halimes, Elvanes [vajza e Jakupit], vajzës së saj Valentines, djaloshit Xhaferit, të cilin Sofija e mbante ngrykë, Hyres dhe nipit të saj Altinit, tre vjeç, si dhe Sevdijes, e cila atë ditë kishte ardhur me familjen e vet nga Banja. Rreth 50 persona u plagosën.

Përderisa vazhdonte bombardimi, të mbijetuarit u tërhoqën me trupat e grave dhe fëmijëve të vrarë në thellësi të pyllit. Trupin e të pajetë të Xhaferit të vogël e kanë mbështjell me një batanije dhe e kanë lënë në djep pranë disa trupave të pajetë. Në mbrëmje, kur bombardimi pushoi, i biri i Hyres me dy të afërm i kanë bartur trupat e së ëmës dhe të Altinit në shtëpinë e vetë, në fshat. Trupat e të vrarëve të tjerë kanë mbetur në pyll edhe ditën e nesërme, ngase forcat serbe u vënin zjarrin traktorëve me teshat dhe ushqimet që kanë mbetur pas shkapërderdhjes së turmës së njerëzve. Në datën 29.08.1998, në praninë e përfaqësuesve të organizatave ndërkombëtare, banorët i kanë marrë dhe i kanë bartur në fshat trupat e Zades, Halimes, Elvanes, Valentines dhe Sevdijes. Vetëm trupin e Xhaferit të vogël nuk e gjetën në vendin ku e kishin lënë. Ditën tjetër, në prani të përfaqësuesve të KNKK-së, OSBE-së dhe *Mjekëve pa Kufij*, banorët dhe familjarët i kanë varrosur Zaden, Elvanen, Sevdijen, Halimen dhe Valentinen në pyll te vendi